



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Njoftim për shtyrje afati të projekteve

2018-02-12 14:59:00

Ministria e Kulturës njofton të gjithë subjektet që kanë paraqitur projekt aplikime për vitin 2018, se, për shkak të volumit të madh të propozimeve të paraqitura, shtyhet afati i vlerësimit përfundimtar të projekteve. Fondi i Ministrisë së Kulturës për projektet u hap më datë 4 dhjetor 2017 deri më datë 12 janar 2018. Pranë Ministrisë së Kulturës janë paraqitur 291 projekt-aplikime në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore.

Te nderuar aplikantë,

Ministria e Kulturës njofton të gjithë subjektet që kanë paraqitur projekt aplikime për vitin 2018, se, për shkak të volumit të madh të propozimeve të paraqitura, shtyhet afati i vlerësimit përfundimtar të projekteve.

Fondi i Ministrisë së Kulturës për projektet u hap më datë 4 dhjetor 2017 deri më datë 12 janar 2018. Pranë Ministrisë së Kulturës janë paraqitur 291 projekt-aplikime në art-kulturë dhe trashëgimi kulturore.

Vlerësimi, mbështetet në kriteret e përputhshmërisë me prioritetet e strategjisë së Ministrisë së Kulturës publikuara:

- Platforma dhe programe të edukimit përmes artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore;
- Platforma dhe projekte në funksion të turizmit kulturor, veçanërisht atij bregdetar;
- Projekte që mund të integrohen në kuadër të vitit "Skenderbeut";
- Projekte në kuadër të Vitit të Trashëgimisë Kulturore Europiane;

Mbështetur në përvojën dhe kapacitetet menaxhuese të aplikuesit, projektet duhet të japin garanci në cilësi dhe përmbajtje të aktiviteteve, në aspektet:

- shpërndarje të rezultateve, ndikimit dhe qëndrueshmërisë;
- shtrirje gjeografike / gjinore / moshore / integritet dhe diversitet kulturor;
- ndikimin e projektit në zhvillimin e audiencave;
- angazhimin e potencialit e ri krijues dhe punësim;
- aftësi bashkëpunuese me partnere dhe donatorë të tjerë mbështetës në projekt;

Data e shpalljes së projekteve fituese do të jetë 19 shkurt 2018.